GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2024-2026

# Dëgjimi i IV- të buxhetor
# PROCESVERBAL

I mbajtur në dëgjimin e katërt buxhetor (Organizuar nga KPF) me datën 15.09.2023 në sallën e Kuvendit të komunës në ndërtesën e administratës komunale, duke filluar ne orën 11:00. Takimin e filloi z. Shpejtim Gacaferi, Kryesues i Kuvendit të Komunës i cili fillimisht përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe tregoi se kjo seancë e organizuar është seancë obligative. Për më tutje për informata më të hollësishme rreth buxheti fjalën e kaloi te z. Arten Hamza – zyrtar kryesor financiar dhe njëherit kryesues i GP i formuar me vendim të kryetarit të komunës.

z. Hamza, ZKF - pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje Arten Hamza filloi me prezantimin e dëgjimit të II-të për Buxhetin, ai tha se Qarkorja e I-rë buxhetore 2024/01 është pranuar në Maj përkatësisht me 15.05.2023, më tutje theksoi se janë disa hapa dhe faza drejt hartimit të projekt buxhetit për periudhën 2024/2026 ku si dokument i parë kërkohet qe të hartohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2024/2026 e cila duhet qe te hartohet dhe aprovohet deri me 30.06.2023 dhe te dërgohet ne Ministrinë e financave, punës dhe Transfereve, pastaj do te lëshohet Qarkorja e dytë buxhetore e cila i përcakton kategoritë shpenzuese dhe në bazë të së cilës duhet që të hartohet projekt buxheti 2024/2026 dhe të aprovohet deri me 30 shtator.

Më tutje shpjegoi hapat e hartimit të KAB duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së takimeve dhe dëgjimeve buxhetore deri te hartimi i KAB-it dhe projekt buxhetit.

z. Hamza, ZKF, shtoi se Buxheti i përgjithshëm për 2024 sipas Qarkores se pare 2024/01 është 2,199,836.00 , nga këto si burim financimi janë:

- Granti i përgjithshëm 1,103,827.00
- Granti specifik për arsim 544,726.00
- Granti specifik për shëndetësi 343,227.00, dhe
- Të hyrat vetanake 208,056.00 .

Dhe nga kjo gjatë hartimit të buxhetit fillimisht planifikohen buxheti i shpenzimeve operative pastaj pjesa tjetër planifikohet për investime kapitale ku përafërsisht planifikohet diku rreth 350,000.00 - 400,000.00 € për kategorinë e investime kapitale për vitin 2024.

Pastaj, në muajin Gusht 2023, komuna ka pranuar qarkoren e dyte buxhetore e cila i përcakton kategoritë shpenzuese dhe në bazë të së cilës duhet që të hartohet projekt buxheti 2024/2026 dhe të aprovohet deri me 30 shtator.

Me pranimin e qarkores janë bërë të ditur kufijtë final në kategoritë ekonomike. Ku sipas qarkores 2024/02, është përcaktuar që kategoria ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2024 të jetë në vlerë 1,445,893.00€, kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime në vlerë 246,660.00€, kategoria ekonomike Shpenzime komunale në vlerë 38,500.00€, Kategoria Subvencioneve dhe transfereve në vlerë prej 62,000.00€, shpenzimet kapitale për në vlerë prej 406,784.00€.

Totali i buxhetit për komunën e Junikut për vitin 2024 sipas qarkores buxhetore 2024/02 është parashikuar të jetë 2,199,836.00€.

Po ashtu gjatë diskutimit tha se propozimet nga dëgjimi i parë buxhetor janë pranuar dhe listuar. Ky takim- dëgjim Buxhetor është i për të gjithë qytetarët e Junikut dhe është i fundit sa i përket takimeve të natyrës së tillë për vitin 2024

Gjithashtu të gjitha informatat lidhur me planifikim buxheti janë publike dhe mund ti gjeni në web faqen e komunës së Junikut.
Me kaq e mbylli prezantimin e tij kryesuesi i Grupit Punues z, Arten Hamza i cili më pastaj fjalën ua e kaloi tek pjesëmarrëset për **propozimet nga D. Buxhetor nga KPF**

Nga të pranishmit fjalën e morën:

- **Z. Zenel Maloku** : Ndërtimi i rrugës në Gjocaj
- **Zeçë Gaxherri:** Rehabilitimi dhe funksionalizimi i pendës së Travës, dhe ndërtimi i kanaleve të ujitjes për të dy krahët e ujitjes ( dy anët e rrugës).
- **Sali Gacaferi:** Kanalizimi te rruga e Nivokazit,
- Rregullimi i shëtitores te Ereniku,
- Rregullimi i fushës së sportit te Ereniku.
- **Beqë Knushi:** Ndërtimi i një rampe për qasje për persona me nevoja të veçanta te objekti i QKMF,
- Kanali i ujitjes në lagjen Bajraktar me gjatësi rreth 100 m.
- **Xhavit Gaxherri:** Ndërtimi i parkut apo këndit të lodrave për fëmijë në Lagjen Gaxherr i epërm,
- Hapja- ndërtimi i rrugës nga varrezat e qytezës në drejtim të shtëpisë së dëshmorit Xhafer Kukaj -Krasniqi,
- Hapja apo ndërtimi i 1 km shtrat te lumi Trava me fillim nga ura e deri te varrezat e qytetit,
- **Sundim Krasniqi:** Ndërtimi i kanaleve të ujitjes ( Jazi i katunit) nga shpia e Asllan Llollunit e deri te lagja Kukaj,
- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes me gjatësi 100m nga shpia e Sundim Krasniqit e deri te lagja Shalaj.
- **Mursel Salihaj:** Rruga te Bunari i fushës (Aravce),

- Vazhdim i kanalit të ujitjes (Setkovce),
- Asfaltimi i rrugës së turbis,
- Ndërtimi i rrugës së Qallakve (kubëza),
- Ndriçimi publik rruga e turbis.
- **Rrustem Pepshi:** asfaltimi i dy rrugëve në lagjen Pepsh (njëra fushore dhe tjetra lokale),
- Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës në lagjen Pepsh në zonën pranë varrezave,

Pastaj z. Arten Hamza mori fjalën përmbyllëse pasi nuk pati propozime tjera duke falënderuar të pranishmit.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe mirë u takofshim në dëgjimet e radhës.

Në këtë dëgjim publik ishin gjithsejtë 20 pjesëmarrës ku 5 nga totali i pjesëmarrësve ishin të gjinisë femërore.

Procesmbajtëse:

I.d.a Ferdone Tofaj

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Komiteti per Politike dhe Financa

Datë: 15.09.2023

# DËGJIMI PUBLIK PËR BUXHETIN 2024-2026 ME QYTETARËT E KOMUNËS SË JUNIKUT

| Numri | Emri dhe Mbiemri | Komuna | Nr. i telefonit | Email-i | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Zenel Malokaj | Junik | 044.840 5[illegible] | | |
| 2 | Zgjim Isufaj | JUNIK | 044 286 888 | gzimi888@gmail.com | |
| 3 | SHABAN ISUFAJ | JUNIK | 044-182-750 | | |
| 4 | BEQË KNUSHI | JUNIK | 044.407.569 | | |
| 5 | Sali Gacaj | Junik | 044496089 | | |
| 6 | Sundim Krasniqi | Junik | 044555293 | | |
| 7 | Valbona Gaxherri | Junik | 045 276826 | | |
| 8 | Mursel Selaj | Junik | 044.253-387 | | |
| 9 | Saranda Isufaj | Junik | | | |
| 10 | Bujar Miroci | Junik | 045 547-244 | bujarmiroci@hotmail.com | |
| 11 | Lindita Shehu | Junik | 049-532 559 | shehulindita@gmail.com | |
| 12 | Arton Krasniqi | Junik | 044270923 | artonkrasniqi@hotma[illegible] | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Demokrat Ganijaj | Junik | 049-409-100 | demokrat.ganijaj@rks-gov.net | |
| 14 | XHAVIT GAXHERRI | JUNIK | 044/676-236 | | |
| 15 | Rrostem Pepaj | JUNIK | 044714046 | | |
| 16 | Gentiana Tofaj | JUNIK | 046-106-306 | gentiana.tofaj@rks-gov.net | |
| 17 | Leonora Shehu | Junik | 046-106-300 | leonora.mshehu@rks-gov.net | |
| 18 | ARTEN HAMZA | JUNIK | 044 264 079 | arten.hamza@rks-gov.net | |
| 19 | Shpejtim Gacaferri | Junik | 044 270 947 | shpejtim.gacaferri@rks-gov.net | |
| 20 | Ruzhdi Shehu | Junik | 044 742 742 | ruzhdi.shehu@rks-gov.net | |
| 21 | | | | | |
| 22 | | | | | |
| 23 | | | | | |
| 24 | | | | | |
| 25 | | | | | |
| 26 | | | | | |
| 27 | | | | | |
| 28 | | | | | |
| 29 | | | | | |
| 30 | | | | | |
| 31 | | | | | |
| 32 | | | | | |
| 33 | | | | | |
| 34 | | | | | |
| 35 | | | | | |
| 36 | | | | | |
| 37 | | | | | |
| 38 | | | | | |